

Kuvendi i Aleancës Kosova e Re, në mbledhjen e mbajtur më 6 maj 2017, bazuar në nenin 36 të Statutit të AKR-së, lidhur me përgjegjësitë dhe me kompetencat, miraton këtë:

DEKLARATË POLITIKE

1. AKR vlerëson se Kosova po përballet me një krizë të madhe politike, ekonomike dhe sociale, andaj fton qytetarët të jenë të vëmendshëm dhe të mos bien pre e lojërave politike të subjekteve që kanë krijuar këtë situatë dhe tani po duan t'i përdorin për poena politikë.
2. Vlerësohet i përmyllur me sukses të plotë procesi zgjedhor brenda partisë, dhe organet e reja të AKR-së të udhëhequra nga Presidenti Behgjet Pacolli e kanë mbështetjen e plotë të Kuvendit, degëve dhe të gjitha strukturave të tjera partiake.
3. AKR mbështet kërkesën për largimin e kësaj qeverie dhe beson se kjo duhet të ndodhë sa më parë, për t'i dhënë një rast zhvillimit të vendit.
4. Mbetja në izolim e qytetarëve të Kosovës si pasojë e mosmarrëveshjeve politike dhe keqqeverisjes është tejet e dëmshme për Kosovën dhe qytetarët e saj.
5. Mungesa e njohjeve për shtetin e Kosovës e dëmton rrugën e integritit dhe bashkëpunimit të Republikës së Kosovës me shtete e organizata ndërkombëtare. Kanë dështuar Politika e jashtme e Kosovës dhe lobimi për njohjet.

6. Mashtrimet për rritje pagash, duke mos pasur një zhvillim ekonomik shkaktojnë pritje tek shërbyesit civil, të cilat më vonë mund të shndërrohen në revoltë.
7. Procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe ndërmarrjeve publike ka shkatërruar ekonominë e vendit dhe kërkohet që urgjentisht të ndërpritet ky proces në mënyrën se si bëhet tani. Duke zbatuar përcaktimin programor të AKR-së për procesin e privatizimit krijohet një shans e re për zhvillimin e atyre ndërmarrjeve që ende nuk janë shkatërruar nga privatizimi.
8. Kosova ka humbur shumë kohë, dhe është moment i fundit që vendi të udhëhiqet nga një program ekonomik, ashtu që t'i jepet mundësia investitorëve të jahstëm dhe diasporës, si edhe investitorëve të brendshëm të investojnë lirshëm për hapjen e vendeve të reja të punës.
9. AKR vlerëson se administrata publike në vend, në të gjitha nivelet, është e mbingarkuar me numër të punëtorëve dhe joefikase. Ajo është shndërruar në problem serioz për qytetarët dhe me ndikim të dëmshëm në zhvillimin ekonomik dhe ngritjen e mirëqenies sociale. Reforma e kësaj administrate është detyrë urgjente, ashtu kritere kryesore për punë në këtë administratë të jenë ngritja profesionale, efikasiteti dhe cilësia e punës.
10. AKR e vlerëson si mjaftë të rëndë gjendjen në arsimin kosovar. Në këtë sektor reformat janë më se të nevojshme, sepse vazhdimi i kësaj gjendje do të ndëshkojë gjeneratat që vijnë.
11. Miliona euro paguhen nga pacientët kosovarë në spitalet e shteteve të rajonit për shkak të dështimit të zhvillimit dhe të menaxhimit të sektorit të shëndetësisë, prandaj reformat në shëndetësi duhet të jenë të menjëhershme.

12. AKR konsideron se punët publike në infrastrukturë po kryhen me një cilësi mjaft të dobët dhe pa mbikëqyrjen e duhur. Shumë projekte që realizohen nuk kanë jetëgjatësi më shumë se dy tri vite dhe duhet të riparohen ose rindërtohen sërish.
13. AKR konsideron se çështja e demarkacionit me Malin e Zi do të duhet të ishte dërguar në arbitrazh ndërkombëtar qysh para dy vitesh, kur edhe e kemi kërkuar këtë gjë. Një marrëveshje mes Kosovës dhe Malit të Zi për ta dërguar procesin në arbitrazh dhe për ta pranuar paraprakisht vendimin e arbitrazhit do të kursente Kosovën nga shumë pasoja që shkaktojnë kjo temë.
14. AKR është e gatshme për zgjedhjet nacionale dhe ato lokale dhe pret të jetë fituesja e tyre. Bashkëpunimet tona të mundshme mund të ndodhin me të gjithë ata që pranojnë programin ekonomik të AKR-së si dhe japin mbështetje që ky program të udhëhiqet vetëm nga AKR-ja.
15. AKR mirëpret ardhjen në strukturat e saja të rinisë dhe femrave në veçanti, duke u ofruar atyre një hapësirë të mjaftueshme veprimi. AKR inkurajon qytetarët e Kosovës që t'i bashkohen vizionit tonë për ta bërë Kosovën Madhështore dhe një vend ku jetohet mirë dhe me dinjitet.

Prishtinë, 06 maj 2017

